

ОПШТИНА КИЧЕВО
www.kicevo.gov.mk
kicevo2025@kicevo.gov.mk
тел. 045/ 22 00 20



KOMUNA E KËRÇOVËS
www.kercova.gov.mk
kicevo2025@kicevo.gov.mk
tel. 045/ 22 00 20



PROGRAMI DHE AKTIVITETE NË LËMIN E MENAXHIMIT ME MJEDISIT JETËSOR NË KOMUNËN E KËRÇOVËS



Kërçovë 2026

PROGRAMI PËR AKTIVITETE NË LËMIN E MENAXHIMIT ME MJEDISIT JETËSOR NË KOMUNËN E KËRÇOVËS

HYRJE:

Ambienti është ai në të cilin njeriu zhvillon veprimtarinë e tij jetësore dhe pa të, ai nuk do të mund të ekzistonte. Duke u fokusuar tek mënyra se si të fitojë më shumë para, njeriu po e anashkalon kujdesin ndaj ekuilibrave natyrorë. Duke u nisur nga fakti se me ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit, dëmtohen e gradualisht shkatërrohen ekosistemet dhe habitatet natyrore të kafshëve dhe bimëve. Dëmtimi i florës dhe faunës, njëkohësisht sjell përkeqësimin e gjëndjes së mjedisit dhe cilësisë së jetës. Duke parë rëndësinë e mjedisit, lind nevoja e madhe për mbrojtjen e tij. Me kete program parashikojm qe sadopak te ndikojm ne permisimin e ambientit jetsor, por edhe te parandalojm ne ndotjen e ambientit jetsor.

Ndotja e ambientit jetsor paraqet ndotjen e sipërfaqes natyrore të Tokës nga aktivitetet industriale, komerciale, shtëpiake dhe bujqësore. Mënyra më e mirë për të parandaluar ndotjen e ambientit jetsor është përmes menaxhimit të mbeturinave në mënyrë te organizuar, shfrytëzimit të tokës në mënyrë te organizuar dhe praktikave adekuate bujqësore. Në vendin tonë rastet e ndotjes së tokës janë të shumta.

- Pastrimi i deponive të egra nga mbeturinat komunale të cilat paraqiten në rajonin e komunës
- Rregullimi i hapsirës (rregullim, mbjellje)
- Pastrimi i përhershëm i deponive të egra nga mbeturinat ndërtimore
- Pastrimi i shtretërve të lumenjëve
- Hartimi i dokumentacionit teknik
- Larja e rregullt e rrugëve
- Dhënia e paisjeve kondicionerve me efikasitet të lartë
- Ngritja e vetëdijes publike

1.Pastrimin e deponive te egra

Ne Komunen e kercove mungon deponija e rregullt komunale prandaj edhe ballafaqimi me mebeturiant komunale e veshtirson punen e Ndermarjes publike por edhe vet Komunes. Si mungese e kesaj deponie ne territorin e Komunes se kercoves jan detektuar nje sere deponish te egra te cilat ndikojn ne ndotjen e ambientit jetsor. Keto depon gjenden ne periferi te vendbanimeve por ndikojne ne ndotjen e ambientit por edhe te ajrit

Ne vitin 2026 Komuna e Kercoves per tejkalimin e ketij problemi dhe per te ndikuar ne permisimin e ambientit jetsor ka ne plan te ndërmari njeserë aktivitetesht per pastrimin e tyre edhe ate:

1. Thirrje publike per banoret per te paraqitur vendodhje te deponive te egra
2. Hartimin e specifikacionin e sasis se mbeturinave ne teren
3. Shpalljen e thirrjes [ublike per realizimin e punve ne teren
4. Pastrimin e deponive te egra.

2.Furnizimi I koshave të gjelbërta për mbeturinat komunale

Koshat e gjelbërta do tu jepen qytetarëve me qëllim që të respektohet plotësisht ndarja e mbeturinave

Është planifikuar bashkëpunim me Ndërrmarjen Publike Komunale për modernizim të infrastrukturës dhe të vendoset sistem për mbledhje, selektim dhe trajtim të mbeturinave të ngurta në përputhje me standardet Evropiane, për atë qëllim Komuna e Kërçovës do të sigurojë kosha për selektim të mbeturinave për secilën amvisëri.

3. Rregullimin e hapsirave te gjelberta

Si mase tjeter qe Komuna e Kercoves planifikon per permisimin e ambientit jetsor sidomos ne permisimin e ajrit eshte edhe mbjellja e fidaneve te rinje ne vendet publike dhe vendet, pergjat rrugve dhe rrugicave, pyllzimin e hapsirave te pa pyllzuara.

Duke e ditur se drunjt dhe gjelberimi eshte si nje nga filtruesit kryesor i ajrit, dhe rrit cilësinë e ajrit dhe ndihmon që hapësirat urbane të prodhojnë vetë një pjesë të oksigjenit, Komuna e Kercoves vazhdimisht ne vitet e kaluara ka bere bjelljen e drunjve te rinj dhe mirmbatjen e hapsirave te gjelberta. Kete aktivitet planifikojm q e ta vazhdoj edhe gjat vitit 2026.

Sipërfaqet e braktisura dhe pluhuri janë gjithashtu një burim i madh i ndotjes në qendrat urbane. Mbetjet e vonuara dhe mbetjet në të njëjtën sipërfaqe e rëndojnë më tej gjendjen dhe ndezja e tyre e shpeshtë është shumë e rrezikshme për të gjitha

vendbanimet përreth. Prandaj, këto aktivitete do të kenë prioritet edhe në realizimin dhe permisimin duke mbjellur drunje dekorativ dhe vegjetacion qeter duke ja pershtatut terenit dhe hapsires. Gjithashtu si mase tjeter eshte qe te motivojm edhe amvisit dhe familjet qe kane hapsire private per mbjelljen e fidaneve te reja, dhe duke I motivuar ne mirmabtjen e hapsirave te gjelberta ne oborret e banimit. Per realizimin e kesaj mase do te merren keto aktivitete:

1. Detektimi I hapsirave publike per mbjellje te fidaneve te rinj
2. Detektimi I Hapsira te braktisura per rregullim horikulturor
3. Furnizimi me fidan te rinje
4. Aktivitete rreth mbjelljes dhe rregullimit te hapsirave te gjelberta
5. rregullimin dhe mirbatjen permanente te hapzires se gjelbert ne objektin e Komunes
6. Ndryshimi I planifikimit urban duke parashikuar hapsira te reja te gjelberta

4. Pastrimin e mbeturinave te ngurta ndertimore

Mbeturinat ndertimore mbeten ndotes kryesor te ambientit jetsor, zgjerimi i ndertimit dhe mosrespektimi i rregullave ligjore per ndertimin dhe sigurimin e ndertesave në ndërtim, si dhe shtyrja e parregullt e mbeturinave ndertimore në vitet e fundit, kontribuon dukshëm në ndotjen, ndër të tjera, edhe të ajrit. Ne Komunen e Kercoves gjendja momentale eshte e padeshirueshme me mbeturina ndertimore te hudhura pa kriter nga ndertuesit neper hapsira publike, afer lumenjve, proskave dhe pyjeve. Per permisimin e ketij ndotsi Komuna e Kercoves do te marr nje sere masa ne dy aspektene pastrimin e e ketyre mbeturinave dhe parandalimin e rendimit te gjendjes edhe ate:

- Kotrollin permanent kompanive ndertuese
- Percaktimin e vendeve te posacme per deponim
- Pastrimin e mbetjeve ndertimore nga hapsirat e ndryshme
- Deponimin e tyre ne vendet te cilat nuk ndosin ambientin

5.Pastrimin e shtreterve te lumenjve dhe prroskave

Komuna e Kërçovës është e vendosur në pjesën perëndimore të Republikës Veriore të Maqedonisë, lugina e Kërçovës paraqet tërësi natyrale në formë të qartë, nga të gjitha anët e rrethuara nga male të larta dhe që i përkasin zonës së sipërme të lumit Treska, në anën veriore arrin deri në Strazë dhe malet Bukovik dhe Ujëmiri, në anën perëndimore ngrihet Mali i Bistrës në anën jugore shtrihet Baba,

Saç dhe Musica, etj, në anën lindore lugina arrin deri në pjesën veriore të Poreçes.

Qyteti i Kërçovës si qendër urbane ndodhet në një lartësi prej 620 deri 650 m, dhe pjesa tjetër e vendbanimeve janë në një lartësi prej 600 deri 1000 m.

Në të njëjtën kohë, komuna është e pasur me lumenjë si lumi Treska, lumi i Zajazit dhe ai i Sushicës si dhe disa lumenjë më të vogël siç janë Studençica, Lumi i Rbetinskës etj. Shumica e këtyre lumenjve, veçanërisht atyre që kalojnë nëpër zona të banuar, përballen me ndotje të rëndë nga mbeturinat e depozituara komunale dhe industriale si dhe mbeturinat e ndërtimeve, dhe gjatë sezonit të shirave ka përmytje të cilat shkaktojnë dëme të mëdha dhe ndotje të mjedisit natyror dhe njerëzor. Pastrimi dhe rregullimi i shtretërve të lumenjve mbetet përparësi e Komunës së Kërçovës për këtë qëllim janë ndërmarrë aktivitetet e mëposhtme:

- Detektimi dhe evidentimi i lumenjve dhe kanaleve dhe proskave të cilat janë të ndotura nga inertet të ndryshme
- Rregullimi dhe hapja e shtretërve të lumenjve të cilat kanë pengesa në rrjedhje për shkak të erozioni të tokës
- Prerjen krasitjen dhe mbartjen e vegetacionit të ulet dhe të lartë për gjatë rrjedhave të lumenjve
- Hapjen dhe pastrimin e kanaleve kulluese
- Hapjen dhe pastrimin e kanaleve dhe proskave nëpër viset rurale dhe urbane me prioritet: kanalin nga lagja Ivanidol dhe mbaron në lumin e qytetit, kanalin në rrugën Uzicka, kanalin në rrugën Arso Vojvoda kanalin në fsh. Cervice hapjen dhe pastrimin e kanalit në Dërgovë dhe Sërbjan dhe burimin në f. Popllzhan

Indikatorët duhet të jenë gjithashtu tregues të matshëm me qëllim monitorimin e realizimit të planit për pastrimin e kanaleve që janë një nga ndotësit kryesorë dhe gjithashtu shkaktojnë sëmundjeve infektive të popullatës në territorin e Komunës së Kërçovës.

6. Përgaditjen e projekteve ekologjike

Komuna e Kercoves vazhdimisht ballafaqohet me problemin e dokumentacionit teknik per investime kapitale ne sferen e ekologjies prandaj nje pjese nga buxheti I vitit

2025 do te ndahen mjete per hartimin e proekteve te cilat do te ndikojn ne ambientin jetsor. Si prioritet japim per keto proekte: rregullimi i shtratit te lumit te Zajazit pjesen nga Stadiumi i qytetit deri te kompleksi Vëllazerimi, ndertimin e kolektorit te kanalizimeve fekal ne pjesen veriore te Komunes se kercoves te cilat nuk jane te parapara ne fazen e dyt te ndertimit te kanalizimeve nga IPA fondet, hartimin e proektit per kanalizimin fekal per fsh.Kollarë. dhe proekte tjera te cilat do te ndikojne ne permisimin e ambientit jetsor. te cilat proekte do te percaktohen nga forume te cilat do te mbahem me sektorin civil dhe shoqatat qytetare. Për realizimin e kesaj mase do te merren keto aktivitete:

- Mbjajtjen e tribunes me qytetaret
- Angazhimin e kompanis proektuse

7.Larjen e rrugve dhe rrugicave

Komuna e Kercoves nepermjet te nderrmarjes komunale edhe ne te kaluaren koh paskohe ka bere larjen e rrugve kryesore te qytetit. Kete aktivitet mendojm ta zgjerojm edhe ne rruget periferike edhe ata rurale. Duke e ditur se veprimatria kryesore e populates se kercoves eshte bujqesia dhe levizja e maqinerive bujqesore nga fushat ne rruget kryesore vjen deri te ndotje me dhe dhe pluhur prandaj larja permanente e rrugve do te ndikonte ne parandalimin e pluhurit e ndotsve te tjere. Poashtu maqinerit ndertimore jane njeri nga shkatktaret e ndotjes se rrugve dhe rrugicave. Ne ojesen veriore ku graviton TEC Oslome nga maqinerit punuesi te keti kombinati vjen deri te ndotja e rrugve te asaj pjese e cila e veshtirson levizjen e populates do te merren masa qe ajo pjese te mirbahet vazhdimisht.

8.Dhënia e paisjeve kondicionerve me efikasitet të lartë

Ndotja e ajrit është problem më serioz me të cilin përballet civilizimi ynë, më së shpeshti shkaktohet nga aktivitetet njerëzore dmth., çdo aktivitet që përfshin djegie kontribon në ndotjen e ajrit. Duke pasur parasysh ndotjen e ajrit që është njëri nga problemet më të mëdha me të cilin përballemi, do të ndëmarrim aktivitete për dubvencionimin e kondicionerve ekologjik për ngrohje me të cilët do të kontribojmë në uljen e ndotjes së ajrit. Pas zbatimit të suksesshëm të masës së vjetëshme për blerjen e paisjeve klima inverter, do të aplikojmë deri te Qeveria e RMV-së për vazhdimin e masës së njejtë edhe në vitin 2026.

9.Ngritjen e vetdijës

Mjedisi perfaqeson vete njeriun. Ai pasqyron jeten e njeriut si nje liber i hapur. Qe ne momentin qe lind e deri kur vdes njerezit jane kontakt te panderprere me mjedisin. Ne nga ai marrim te gjitha elementet e nevojshme per jeten. Me pak fjale ne ekzistojme sepse mjedisi ekziston. Natyra na ka falur nje te mire te jashtezakonshme. Si cdo gje tjetre te mire ne ia kuptojme rendesine vetem ne castin kur e humbasin. Prandaj do te mundohemi q eta bindimi njeriun per ta mirmbajt ambientin jetsor duke ndikuar ne ngritjen e vetedies qe na kanoste nga nje ambient jo i paster

Ngritja e vetëdijes publike përmes fushatave edukative do të jetë një nga aktivitetet prioritare në këtë program, që do të kenë për qëllim t'i informojë qytetarët për dëmshmërinë e përdorimit të burimeve jo-ekologjike të ngrohjes, por gjithashtu t'i edukojnë ato për alternativat më efikase, më ekologjike dhe mundësit ekonomike më të qëndrueshme për ngrohje, transport, menjanim të mbeturinave etj. Këte masë planifikojm ta realizojmë duke mare këto aktivitete:

- Puntorii me ekspert te ambientit jetsor,
- Kampanje mediale per ruajtjen e ambientit jetsor
- Akcion ekologjik me sektorin public dhe kycjen e sektrit privat
- Mbajtjen e orës ekologjike nëpër shkollat fillore dhe te mesme
- Pergaditja e fletushkave dhe flaerave per mbrotje te ambientit jetsor
- Vendosja e koshave per selektim te mbeturinave

Përmirësimi i kapaciteteve të inspektoratit të mjedist jetsor : për kryerjen e mbikëqyrjes së inspektimit, me qëllim që të sigurohet zbatim i plotë i rregullave përkatëse ligjore për mbrojtjen e mjedisit. Aktivitetet do të përfshijnë:

- Rritjen e numrit të të punësuarve;
- Rritjen e vëllimit të kontrolleve të rregullta;
- Futena e një sistemi më efikas për kryerjen e kontrolleve të inspektimit

KONSTRUKTI FINANSIAR

MASA	Vlera
Pastrimin e deponive te egra	6.000.000

Kosha për mbeturinat	1.000.000
Rregullimin e hapsirave te gjelberta	3.000.000
Pastrimin e mbeturinave te ngurta ndertimore	1.000.000
Pastrimin e shtreterve te lumenjve dhe prroskave	2.500.000
Pergaditjen e proekteve ekologjike	600.000
Larjen e rrugve dhe rrugicave	60.000
Kondicionerë me efikasitet të lartë	4.000.000
Ngritjen e vetdijës	300.000

- Mjetet e nevojshme për realizimin e këtij Programit, janë përcaktuar në Buxhetin e Komunës së Kërcovës për vitin 2026,
- Buxheti i Republikës e Maqedonisë Veriore për vitin 2026 (përmes ministrive kompetente),
- Shoqëri tregtare, ndërmarrje publike, fonde dhe persona tjerë juridik dhe fizik;
- Partnerë të interesuar për bashkëpunim të ndërsjellë në vend dhe jashtë;
- Burime tjera.

V. DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Kryetari i Komunës së Kërcovës kujdeset dhe e siguron realizimin e këtij Programi.

Njesia per ambient jetsor e ndjek realizimin e këtij Programi, ngre iniciativa, jep mendime dhe parashton propozim në lidhje me realizimin e qëllimeve dhe aktiviteteve të parashikuara.

Ky program hyn në fuqi ditën e shpalljes në “Fletoren Zyrtare të Komunës së Kërcovës.”.

Përgatiti:

Inxh.-bioteknolog: Emilija Petkoska

Nr. _____

Dt. ____ . ____ . ____

Kërçovë

Këshilli i Komunës së Kërçovës

Kryetar,

Ајхан Сулкоски / Ajhan Sulkoski
